



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.1, datë 13.01.2022

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMËRTIMIT TË RRUGËS “ERIH MARIA
REMARK” NË RRUGA “BENEDIK BRAHJA”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 3, të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 475, datë 23.12.2017 “Për miratimin e sistemit të ri të adresave të Bashkisë Durrës” i ndryshuar, si edhe sipas relacionit të Drejtorisë së Arsim, Kulturë, Sport, Rini, Komunitete Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të Rrugës “Erih Maria Remark” në rruga “Benedik Brahja”, sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Sport, Rini, Komunitete Fetare dhe Ndërmarrja Rruga.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 13.01.2022

PLANI I VENDNDODHJES SË RRUGËS "BENEDIK BRAHJA"



ISHITE

ERIH MARIA REMARK



BËHET

BENEDIK BRAHJA




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 24/1 prot.

Durrës, më 13.01.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK ✓
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.1 datë 13.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës “Erih Maria Remark” në rruga “Benedik Brahja”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

